

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 6545 prot.

Vlorë, më 21.05.2018

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 08.05.2018**

**PËR  
RREGULLOREN E PËRDORIMIT TË *ITHENTICATE*, SOFTWARE-it PËR  
DETEKTIMIN E PLAGJIATURËS NË VEPRIMPTARINË  
KËRKIMORE DHE BOTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Mbështetur në nenin 33, pika 3, nenin 38, pika 1, shkronja d të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në mbështetje të Rregullores së etikës së kërkimit shkencor dhe publikimit në UV, miratuar me Vendim të Senatit Akademik, nr. 102, datë 06.12.2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2018

**VENDOSI:**


1. Të miratojë Rregulloren e përdorimit të *Ithenticate*, software-it për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në UV..
2. Teksti i rregullores ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Rektori, Zv/rektorët, Sektori i Karrierës Akademike, Sektori i Kërkimit Shkencor, njësitë bazë dhe kryesore të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**RREGULLORE**

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË *ITHENTICATE*, SOFTWARE-it PËR  
DETEKTIMIN E PLAGJIATURËS NË VEPRIMPTARINË  
KËRKIMORE DHE BOTUESE NË UV**

**Neni 1**

Përmes kësaj rregulloreje rregullohet mënyra e përdorimit të *Ithenticate*, *software*-it për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.  
Me vendim të posaçëm, rektori cakton një apo më shumë persona të punësuar në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, të cilët do të kryejnë punët operativo-teknike të përdorimit të *software*-it për kontrollin e plagjiaturës.

**I – Përdorimi i *software*-it për kontrollin dhe detektimin e plagjiaturës në punimet e doktoratës**

**Neni 2**

Çdo disertacion i punuar, i paraqitur pranë fakultetit përkatës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë duhet t'i nënshtrohet kontrollit përmes përdorimit të *software*-it për detektimin e plagjiaturës.

**Neni 3**

Rezultati i kontrollit të disertacionit të doktoratës përmes përdorimit të *software*-it për detektimin e plagjiaturës është pjesë e domosdoshme e raportit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".


**Neni 4**

Kontrolli i disertacionit me përdorimin e *software*-it për detektimin e plagjiaturës do të realizohet në këtë mënyrë:

-Dekani i fakultetit, i cili ka pranuar disertacionin e punuar nga kandidati për doktoratë, brenda një afati prej 5 ditësh, nga dita e pranimit ia dërgon Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë disertacionin në formë elektronike në adresën e email-it [rektori@univlora.edu.al](mailto:rektori@univlora.edu.al), me kërkesën për realizimin e procesit të detektimit për plagjiaturë.

-personat e caktuar me vendim të rektorit realizojnë procesin e detektimit për plagjiaturë brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimit të kërkesës nga fakulteti dhe raportin ia dërgojnë rektorit.

-rektori i universitetit ia dërgon rezultatet e kontrollit të disertacionit dekanit të fakultetit që ka bërë kërkesën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

-dekani i fakultetit ia dërgon rezultatet e kontrollit të disertacionit Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", së bashku me çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për përpilimin e raportit lidhur me disertacionin e dorëzuar.

**II – Përdorimi i *software*-it për detektimin e plagjiaturës në kuadër të veprimtarisë akademike të Senatit Akademik dhe këshillave shkencorë dhe botues**

**Neni 5**

Senati dhe këshillat shkencorë dhe botues, në punën e tyre, mund të përdorin *software*-in për detektimin e plagjiaturës.

Nëse gjatë shqyrtimit të ndonjë çështjeje nga ana e këshillave shkencorë dhe botues lind nevoja për përdorimin e këtij *software*-i, ato i paraqesin Senatit Akademik kërkesën për përdorimin e *software*-it. Senati Akademik pas shqyrtimit të kërkesës autorizon përdorimin e *software*-it.

**Neni 6**

Këshillat shkencorë dhe botues i dërgojnë Kryetarit të Senatit në formë elektronike punimin/et shkencor/ë, publikimin/et apo çdo dorëshkrim tjetër që ka marrë miratimin nga Senati Akademik për t'iu nënshtruar kontrollit përmes përdorimit të *software*-it për detektimin e plagjiaturës.

Personat e autorizuar, me vendim të rektorit, realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës dhe raportin ia dorëzojnë rektorit, i cili ia dërgon Senatit Akademik. Rezultatet e kontrollit i përcillen këshillave shkencorë dhe botues brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimit të raportit nga Senati Akademik.

**III – Përdorimi i *software*-it për detektimin e plagjiaturës për çështje të dërguara Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim dhe Këshillit të Etikës**


**Neni 7**

Bordi i Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim, në punën e vet, mund ta përdorë *software*-in për detektimin e plagjiaturës.

Nëse gjatë ndjekjes së procedurës lidhur me ankesë konkrete (kallzim) të parashtruar Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim paraqitet nevoja për përdorimin e këtij *software*-i, atëherë Bordi i Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim nxjerr përfundime lidhur me këtë çështje, të cilat ia relaton dhe përcjell në formë shkresore Këshillit të Etikës.

Në përfundim vlerësohet cili punim shkencor, publikim, apo dorëshkrim duhet të kontrollohet përmes përdorimit të *software*-it për detektimin e plagjiaturës.

**Neni 8**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim ia dërgon Këshillit të Etikës punimin shkencor, publikimin apo dorëshkrimin për të cilin bëhet shqyrtimi në bord, me kërkesën që të ushtrohet kontroll përmes *software*-it për detektimin e plagjiaturës.

Këshilli i Etikës i dërgon Kryetarit të Senatit në formë elektronike punimin/et shkencor, publikimin/et apo çdo dorëshkrim tjetër që ka marrë miratimin nga Këshilli i Etikës për t'iu nënshtruar kontrollit përmes përdorimit të *software*-it për detektimin e plagjiaturës.

Personat e autorizuar, me vendim të Rektorit, realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës dhe raportin ia dorëzojnë Rektorit, i cili ia dërgon Senatit. Rezultatet e kontrollit i përcillen Këshillit të Etikës dhe Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimi të raportit nga Senati Akademik.

#### IV – Dispozita kalimtare dhe të fundit

##### Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.